

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas paditësit Zyra Rregulatorë për Ujësjiellës dhe Mbeturina (ZRRUM) nga Prishtina, kundër të paditurës – Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) 'Uniteti' sh.a. nga Mitrovica, për shkak të rimbursimit në emër të borxhit, duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.68/2017 dt.11.04.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 25.07.2017, mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e paditësit Zyra Rregulatorë për Ujësjiellës dhe Mbeturina, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.68/2017 të datës 11.04.2017

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.68/2017 të datës 11.04.2017, është refuzuar ankesa e paditësit, ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje administrative A.U.nr.2006/2014 dt. 15.12.2016, me të cilin është hedhur poshtë padia e paditësit si e paplotësuar.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.68/2017 dt.11.04.2017, paditësi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, me propozim që të aprovohet kërkesa.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të aktvendimit të goditur në pajtim me nenin 53 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit (ZRRUM), paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dep.administrativ A nr.2006/2014 dt.15.12.2016 me të cilin është hedhë poshtë padia e paditësit si e paplotësuar.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo Gjykatë gjen se gjykata e shkallës së dytë ka vendosur drejtë, dhe e konfirmon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar në prova dhe ligj këtë vendim.

Neni 13 i LKA-së parashikon se konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. Konflikti administrativ mund të

fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar. Sipas nenit 14 të këtij ligji është paraparë se konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuar me këtë ligj. Neni 33 i këtij ligji parasheh se nëse padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta, kryetari i kolegjit do të ftojë paditësin, që brenda afatit prej 8 ditëve t'i menjanojë të metat e padisë. Nëse paditësi brenda afatit të cekur nuk i menjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë me vendim padinë, nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm.

Me aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë nga paditësi është kërkuar që në afat prej 8 ditësh t'i menjanojë të metat e padisë. Paditësi këtë nuk e ka bërë, por me parashtresën e datës 14.12.2016 deklaroi se mbetet në tërësi pran padisë.

Pasi që paditësi nuk ka bërë plotësimin e padisë sipas sugjerimeve të dhëna në aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, andaj vendimi i saj është marrë duke i respektuar dispozitat ligjore dhe procedurale. Këtë e ka vërtetuar edhe gjykata e Apelit me aktvendimin AA UZH nr.68/2017 të datës 11.04.2017.

Janë të pabazuara thëniet e paditësit lidhur me shkeljet, sepse i vlerësoi të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë. Aktgjykimi i goditur është i qartë dhe i kuptueshëm, përmbanë arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se nuk është cënuar ligji në dëm të palës së interesuar dhe është bërë aplikimi i drejt të drejtës materiale.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 54.1 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

ARJ.UZVP.nr.36/2017 dt. 25.07.2017.

Procesmbajtësi,

Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,

Nebojsa Boriçiq

Përktheu : Ferid Abazi